

## NË EMER TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal**, përmes gjyqtares së vetme gjykuese Snezhana Mihajloviq, me sekretaren juridike Suzana Kovaçeviq, në lëndën penale kundër të akuzuarit Sh.A.nga ..., rr. " ... ", për shkak të veprës penale lejimi i njehsorëve të ndryshuar të shërbimeve nga neni 324.paragr.1 KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.2241/17 të datës 29.11.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më dt.23.04.2018, në prezencë të palëve publikisht shpalli

### A K T G J Y K I M

I pandehuri **Sh.A.** nga babai F. dhe nëna F. – I., i lindur më dt. ... në fsh. ..., jeton në ..., rr. " ... " nr. ..., i martuar, baba i tetë fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, deri më tani i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

### Ë S H T Ë F A J T O R

sepse më dt. 13.11.2017 në kohë të pa përcaktuar, në Gjilan, nga punëtorët e autorizuar të KEDS-it është konstatuar se i pandehuri në shtëpinë e tij, me qëllim që vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, pa autorizim ka shfrytëzuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që gjatë kontrollimit, punëtorët kanë vërejtur se i pandehuri me qëllim të shmangies nga pagesa e energjisë elektrike e ka heq njehsorin elektrik nr. ..., me të cilin është furnizuar me energji elektrike, me çka ka bërë shpenzim në mënyrë të paautorizuar, duke e dëmtuar ...-in në shumë prej 140.55 €.

- me çka ka kryer veprën penale lejimi i njehsorëve të ndryshuar të shërbimeve nga neni 324.paragr.1 KPRK.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4,41,42,49,50,51,52, 73 dhe 74 KPRK si dhe nenit 248 dhe 365 KPPK të pandehurit i shqipton

### DËNIM ME KUSHT

**I.** Të pandehurit i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 100 (njëqind) € dhe dënimi me burg në kohëzgjatje prej 3(tre) muajve, të cilat dënime nuk do ekzekutohen nëse i pandehuri brenda periudhës kohore prej 1 viti, nuk kryen tjetër vepër penale, në të kundërtën dënimet me kusht do të revokohen.

**II.** E dëmtuara ... nga ..., për realizimin e kërkesës pronëso-ro-juridike është udhëzuar në kontestin civil.

**III.** Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit të paguaj shumën prej 25 € si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.

## *A r s y e t i m*

*Prokuroria Themelore në Gjilan ka ngritë aktakuzën penale kundër të akuzuarit Sh.A. nga ..., për shkak të veprës penale lejimi i njehsorëve të ndryshuar të shërbimeve nga neni 324.paragr.1 KPRK.*

*Gjatë seancës fillestare të mbajtur më dt. 23.04.2018 në të cilën është lexuar aktakuza e Prokurorisë së shtetit PP.nr.2241/2017 e dt. 29.11.2017, ku pas leximit të aktakuzës i pandehuri Sh.A. ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale e cila i vihet në barrë, duke shtuar se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.*

*Në seancën fillestare publike gjykatësja e vetme gjykuese mori aktvendim me të cilin pranoi pranimin e fajësisë, pasi konstatoi se për këtë gjë janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore. Gjykatësja e vetme ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi është bërë me vullnetin e tij, se pranimi i fajësisë përmban të gjitha faktet të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.*

*Prokurorja nuk pati kurrfarë vërejtje lidhur me pranimin e fajësisë dhe konsideron se për këtë janë plotësuar të gjitha kushtet.*

*Në bazë të cekurave të mësipërme, gjykatësja e vetme gjykuese vërtetoi gjendjen faktike si vijon:*

*Se i pandehuri Sh.A. ka kryer veprën penale lejimi i njehsorëve të ndryshuar të shërbimeve nga neni 324.paragr.1 KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

*Me nenin 324 paragr.1 KPRK është paraparë që “Kushdo që ndërhyt ose shmang njehsorin i cili gjendet në pronën e cila është në posedimin, pronësinë apo kontrollin e tij, për të ofruar shërbime komunale që nuk janë matur ose janë matur në mënyrë të pasaktë, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet”.*

*Në bazë të cekurave të mësipërme, gjykata vendosi që të pandehurin ta shpallë fajtor për kryerjen e veprës penale, pasi që veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha elementet e veprës penale, dhe se për të njëjtat veprime është penalisht përgjegjës.*

*Në bazë të nenit 73 dhe 74 KPRK me rastin e shqiptimit të dënimit kundër të pandehurit, gjyqtarja e vetme gjykuese mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që nga rrethanat lehtësuese gjykata i mori parasysh pranimin e fajësisë, gjendjen e tij mjaft të vështirë ekonomike, se deri më tani nuk ka qenë i gjykuar, nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale, se për shkak të sëmundjes nuk ka mundësi të punoj dhe se shqiptimi i një dënimi më të rëndë për të pandehurin do të ishte fatal për shëndetin e tij, i ka premtuar gjykatës se nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme.*

*Sipas bindjes së kësaj gjykate shqiptimi i dënimit me kusht ndaj të pandehurit Sh.A. është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit. Gjykata konstatoi se me këtë lloj të dënimit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit nga neni 41 KPRK që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej vepra tjera penale, t'i parandaloj personat tjerë në kryerjen e veprave penale dhe të paraqes*

*gjykimin shoqëror për veprën penale, të rris moralin dhe fuqizoj obligimin për të respektuar ligjin.*

*Nga të cekurat e mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**

*P.nr.1303/2017 më dt.23.04.2018*

**Sekretarja juridike,**  
*Suzana Kovaçeviq, d.v.*

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,**  
*Snezhana Mihajllloviq, d.v.*

**UDHËZIMI JURIDIK:** *Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të njëjtit. Ankesa në dy kopje dorëzohet përmes kësaj gjykate.*

**Përktheu –**  
*Naile Keçmezi*



